



Funded by
the European Union



PARTNERËT SHQIPËRI
PËR NDRYSHIM DHE ZHVILLIM

Një çerek shekulli në ndërtimin e komuniteteve!



AKADEMIA E SIPËRMARRJES SOCIALE NË SHQIPËRI

BROSHURË INFORMUESE

Përse një Akademi e Sipërmarrjes Sociale?

Në vitet e fundit, sipërmarrja sociale në Shqipëri ka njohur një zhvillim gradual, duke kontribuar në adresimin e sfidave sociale, ekonomike dhe mjedisore. Megjithatë, ekosistemi mbetet ende në fazë konsolidimi, me nevojë të theksuar për:

- rritje të kapaciteteve menaxheriale dhe financiare;
- modele të qëndrueshme biznesi;
- qeverisje të mirë dhe llogaridhënie;
- akses në financim dhe investime me ndikim;
- sisteme të strukturuar për matjen e ndikimit social.

Shumë sipërmarrje sociale operojnë me motivim të fortë dhe mision të qartë social, por përballen me sfida të shumta që lidhen me zhvillimin e tyre, ndërtimin e strukturave të brendshme profesionale dhe pozicionimin në treg. Në të njëjtën kohë, tranzicioni i gjelbër dhe ai digjital, si dhe procesi i integritit evropian, kërkojnë modele më inovative, më të qëndrueshme dhe më konkurruese.

Në këtë kontekst, lind nevoja për një program të strukturuar kombëtar, që jo vetëm ofron trajnim teorik, por ndërton kapacitete reale, praktike dhe të aplikueshme në terren.

Partnerët Shqipëri për Ndryshim dhe Zhvillim (PSh) është një nga organizatat pioniere në zhvillimin e sipërmarrjes sociale dhe promovimin e ekonomisë sociale në Shqipëri.

Prej më shumë se një dekade, Partnerët Shqipëri:

- Ka kryer studime dhe analiza mbi ekosistemin e sipërmarrjes sociale në nivel kombëtar, rajonal dhe evropian;
- Ka kontribuar në zhvillimin e kuadrit ligjor dhe praktik për ekonominë sociale;
- Ka ofruar programe inkubimi dhe akselerimi për sipërmarrje sociale dhe start-up me ndikim;
- Ka mbështetur qindra organizata dhe biznese sociale përmes mentorimit, ofrimit të granteve dhe rrjetëzimit;
- Ka vendosur ura bashkëpunimi mes OJF-ve, institucioneve publike dhe sektorit privat;
- Ka promovuar aksesin në financim, përmes platformave si **Dua Partner Invest** dhe përmes lidhjeve me rrjete evropiane si Diosis Network, EUCLID, etj.

Kjo eksperiencë shumëvjeçare ka treguar qartë se ekziston nevoja për ndërhyrje të strukturuar, afatgjatë dhe të integruar, që kombinon zhvillimin e aftësive me mbështetje të personalizuar dhe lidhje konkrete me tregun dhe investitorët.

Akademia e Sipërmarrjes Sociale ndërtohet pikërisht mbi këtë eksperiencë të konsoliduar, dhe vjen si një komponent i rëndësishëm i projektit “**Invest for Change – I4CH**”, një nismë që do të zbatohet gjatë viteve 2025-2029, në të gjitha vendet e Ballkanit Perëndimor dhe që synon zhvillimin e sipërmarrjeve me impakt përmes mbështetjes me instrumente financiarë dhe jo-financiarë; krijimin e një komuniteti investitorësh me ndikim në mbështetjen e tyre; ndërtimin e partneriteteve dhe lehtësimin e shkëmbimeve rajonale, si dhe ndërtimin e një dialogu politikash me politikëbërës dhe investitorë për të ndërtuar një ekosistem të qëndrueshëm për ekonominë sociale.



Akademia synon të krijojë një brez sipërmarrësish socialë të pajisur me:

- njohuri të thelluara mbi modelet e ekonomisë sociale;
- aftësi për ndërtimin e modeleve të qëndrueshme të biznesit;
- kompetenca në mobilizimin e burimeve financiare dhe investimeve me ndikim;
- sisteme profesionale të matjes dhe menaxhimit të ndikimit;
- kapacitete për inovacion dhe adaptim ndaj ndryshimeve të tregut.

Programi synon të kontribuojë në ndërtimin e një ekosistemi më të fortë, më të integruar dhe më të qëndrueshëm të sipërmarrjes sociale në Shqipëri, në përputhje me zhvillimet dhe politikat e Bashkimit Evropian për ekonominë sociale.

Çfarë ofron Akademia e Sipërmarrjes Sociale



Akademia e Sipërmarrjes Sociale është një program i strukturuar për zhvillimin profesional të sipërmarrjeve sociale në Shqipëri, i cili synon të forcojë kapacitetet menaxheriale, financiare dhe strategjike të tyre, duke kontribuar në rritjen e qëndrueshmërisë dhe ndikimit të matshëm social.

Akademia e Sipërmarrjes Sociale ofron një paketë të integruar zhvillimi profesional, e cila nis me **ndërtimin e njohurive të thelluara mbi ekonominë sociale dhe kuadrin rregullator** që e mbështet atë. Pjesëmarrësit do të përvetësojnë një kuptim të avancuar të parimeve dhe modeleve të ekonomisë sociale në nivel evropian, të kuadrin ligjor shqiptar për sipërmarrjet sociale, si dhe të formave të qeverisjes dhe strukturimit institucional të sipërmarrjeve me mision social. Njohja e politikave dhe zhvillimeve të Bashkimit Evropian në këtë fushë do t'i ndihmojë ata të operojnë në përputhje me kërkesat ligjore dhe të pozicionohen në mënyrë më strategjike dhe konkurruese në treg.

Programi pajis pjesëmarrësit me **aftësi konkrete për të krijuar dhe zhvilluar modele të qëndrueshme biznesi**, duke i udhëhequr në procesin e ndërtimit dhe rishikimit të modelit të biznesit, hartimit të planeve të biznesit të orientuara drejt rritjes, analizës së tregut dhe zhvillimit të strategjive efektive të marketingut. Përmes këtyre kompetencave, sipërmarrjet sociale do të jenë më të afta të kalojnë nga iniciativa me mision social në struktura të konsoliduara, të qëndrueshme financiarisht dhe të pozicionuara qartë në treg.

Një komponent thelbësor i Akademisë është **forcimi i kompetencave** në menaxhimin financiar dhe mobilizimin e burimeve. Pjesëmarrësit do të zhvillojnë aftësi për të siguruar fonde përmes granteve dhe mekanizmave alternativë të kapitalit, për të ndërtuar strategji afatgjata të diversifikimit të të ardhurave, për t'u përgatitur për investim me ndikim dhe për të prezantuar në mënyrë profesionale sipërmarrjen e tyre përpara investitorëve dhe partnerëve financiarë. Kjo i ndihmon ata të menaxhojnë me përgjegjësi burimet financiare dhe të garantojnë përdorim efikas dhe transparent të tyre.

Akademia gjithashtu ofron **aftësi për të menaxhuar marrëdhëniet me investorët dhe partnerët**, duke forcuar kuptimin e detyrimeve ligjore dhe kontraktuale në marrëdhënien investor–përfitues, ndërtimin e praktikave të qarta të raportimit dhe llogaridhënies, si dhe krijimin e partneriteteve strategjike dhe bashkëpunimeve afatgjata. Kjo rrit besueshmërinë, reputacionin dhe profesionalizmin e sipërmarrjeve sociale brenda ekosistemit.

Një tjetër shtyllë e rëndësishme është **ndërtimi i kapaciteteve për matjen dhe menaxhimin e ndikimit social**. Pjesëmarrësit do të mësojnë të zhvillojnë sisteme të strukturuar të matjes së ndikimit, të përcaktojnë indikatorë dhe korniza monitorimi, si dhe të komunikojnë në mënyrë profesionale rezultatet dhe vlerën e shtuar sociale të ndërhyrjeve të tyre. Kjo u mundëson sipërmarrjeve të demonstrojnë qartë efektin real të punës së tyre ndaj komunitetit, donatorëve dhe investorëve.

Programi forcon gjithashtu **kompetencat në inovacion dhe transformim digjital**, duke nxitur aplikimin e qasjeve të inovacionit social, përdorimin e metodologjive si ‘design thinking’ dhe ‘co-creation’, integrimin e mjeteve digjitale për rritjen e efikasitetit dhe transparencës, si dhe përshtatjen ndaj tranzicionit të gjelbër dhe atij digjital. Kjo i ndihmon sipërmarrjet sociale të jenë më fleksibël, më kreative dhe më të afta për t’u përballur me ndryshimet e tregut.

Së fundmi, përmes Akademisë pjesëmarrësit do të kenë qasje në një rrjet profesionistësh, ekspertësh dhe aktorësh të rëndësishëm të ekosistemit të sipërmarrjes sociale, duke krijuar mundësi konkrete për bashkëpunim ndërsektorial, shkëmbim përvoja dhe partneritete të reja.

Ata do të përfitojnë gjithashtu ekspozim në komponentët e tjerë të projektit, përfshirë thirrje për mbështetje financiare dhe pjesëmarrje në evente kombëtare dhe rajonale/evropiane, si dhe do të pajisen me certifikatë për ndjekjen e programit, si dëshmi e zhvillimit të tyre profesional.

Programi do të zbatohet gjatë periudhës **prill – tetor 2026** dhe do të zhvillohet në format fizik.

Akademia përbëhet nga **7 module tematike**, të organizuara në formën e trajnimeve 1-ditore (minimumi 5 orë për sesion), me rreth 2 sesione në muaj.



- 1** *Hyrje në Ekonominë Sociale dhe Sipërmarrjen Sociale*
- 2** *Themelimi dhe Zhvillimi i Sipërmarrjeve Sociale në Shqipëri*
- 3** *Inovacioni në Sipërmarrjen Sociale*
- 4** *Financimi dhe Mobilizimi i Burimeve*
- 5** *Marrëdhënia Investor–Përfitues*
- 6** *Matja dhe Menaxhimi i Ndikimit*
- 7** *Strategjitë e Qëndrueshmërisë dhe Shkallëzimit*



Datat	Modulet
3 Prill 2026	1 Hyrje në Ekonominë Sociale dhe Sipërmarrjen Sociale - Parimet dhe dallimet me ekonominë tradicionale - Modelet evropiane të sipërmarrjeve sociale - Qeverisja dhe organizimi i SE - Politikat e BE-së për ekonominë sociale
22 Prill 2026	2 Themelimi dhe Zhvillimi i Sipërmarrjeve Sociale në Shqipëri - Kuadri ligjor shqiptare - Modeli i biznesit dhe plani i biznesit - Kërkimi i tregut dhe marketingu
15 Maj 2026	3 Inovacioni në Sipërmarrjen Sociale - Inovacioni social dhe digjital ‘Design thinking’ dhe ‘co-creation’ - Praktika dhe raste konkrete
29 Maj 2026	4 Financimi dhe Mobilizimi i Burimeve - Strategjitë e sigurimit të fondeve - Mekanizma alternativë të sigurimit të kapitalit - Investimi me ndikim ‘Pitching’ për investitorët
25 Qershor 2026	5 Marrëdhënia Investitor–Përfitues - Detyrimet ligjore dhe kontraktuale - Llogaridhënia dhe raportimi - Ndërtimi i partneriteteve
18 Shtator 2026	6 Matja dhe Menaxhimi i Ndikimit - Sistemet e matjes dhe menaxhimit të ndikimit - Modelet dhe indikatorët - Komunikimi i të dhënave të ndikimit
2 Tetor 2026	7 Strategjitë e Qëndrueshmërisë dhe Shkallëzimit - Strategjitë e rritjes - Diversifikimi i të ardhurave - Pozicionimi në treg
Tetor 2026	Ceremonia e Diplomimit


5 Kush mund të aplikojë?

Thirrja është e hapur për aplikantë që operojnë në fusha të lidhura me përfshirjen sociale, punësimin, ekonominë qarkulluese, tranzicionin e gjelbër/digjital, zhvillimin lokal, etj. dhe i përket kategorive të mëposhtme:

- Sipërmarrje sociale në Shqipëri
- Organizata jofitimprurëse me aktivitet sipërmarrës
- Biznese me mision social të qartë dhe ndikim të matshëm
- Iniciativa në fazë inkubimi me model të qartë sipërmarrjeje sociale
- Start-up me fokus në zgjidhje inovative për sfida sociale ose mjedisore



15 pjesëmarrës do të përzgjidhen për Akademinë e Sipërmarrjes Sociale 2026.



6 Procesi i Aplikimit



Të gjithë të interesuarit janë të ftuar të plotësojnë **formularin e aplikimit** deri më **20 mars 2026**.

Vetëm aplikantët e përzgjedhur do të kontaktohen.



POLITIKA JODISKRIMINUESE E PRANIMEVE NE AKADEMI

Në përzgjedhjen e pjesëmarrësve Partnerët Shqipëri do të udhëhiqet nga parimi i mosdiskriminimit mbi baza gjinore, fetare, etnie apo orientimi seksual.

Për informacione të mëtejshme mbi Akademinë e Sipërmarrjes Sociale në Shqipëri dhe procesin e aplikimit, ju mund të kontaktoni Partnerët Shqipëri në:

Email: partners@partnersalbania.org

Website: www.partnersalbania.org

Tel: +355 4 2254881

Mob: 00355 697889600